

**VENDIM**  
**Nr. 141, datë 22.2.2017**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT KOMBËTAR PËR  
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe të nenit 6, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (Autoriteti), është institucion qendror buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve elektronike.

2. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, organizohet si Drejtori e Përgjithshme, me seli në Tiranë, dhe e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Autoriteti ka si objekt të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e nënshkrimit elektronik, identifikimin elektronik e shërbimeve të besuara, si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e sigurisë kibernetike.

4. Autoriteti kryen këto detyra funksionale:

4.1 Ushtron kompetencat e parashikuara për autoritetin përgjegjës në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, për identifikimin elektronik e shërbimet e besuara si dhe për sigurinë kibernetike.

4.2 Garanton sigurinë për shërbimet e besuara, në veçanti për garantimin e besueshmërisë dhe sigurisë në transaksionet elektronike ndërmjet qytetarëve, biznesit dhe autoriteteve publike, duke rritur efektivitetin e shërbimeve publike e private dhe tregtisë elektronike.

4.3 Përcakton rregullat për skemat e identifikimit elektronik, vultat elektronike, transferimin e detyrave të shërbimeve të besuara, shërbimin e transmetimit elektronik, autentifikimin e faqeve të internetit.

4.4 Përcakton rregullat dhe metodat për verifikimin e vlefshmërisë së produkteve të gjeneruara nga shërbimet e besuara, vendase dhe të huaja, duke mundësuar aksesin publik për kontrollin e vlefshmërisë së tyre nëpërmjet listave të besuara të vendeve anëtare të BE-së dhe protokollin *on-line* të statusit të certifikatave dhe listave të revokimit të certifikatave.

4.5 Krijon dhe mirëmban listat e besuara në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve të standardeve të BE-së.

4.6 Miraton formën dhe përmbajtjen e marrëveshjeve, midis ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe palëve të treta, në rast të transferimit të shërbimit.

4.7 Mbikëqyr dhe kontrollon palët e treta, në rastin kur transferohen një ose më shumë nga detyrat e shërbimeve të besuara.

4.8 Realizon kontrollin/monitorimin e zbatimit të standardeve dhe procedurave të lëshimit të certifikatave të kualifikuara nga ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar.

4.9 Nxit dhe promovon shërbimet e besuara në shërbimet publike, të ofruara nga institucionet publike dhe private, ndaj qytetarëve dhe biznesit.

4.10 Merr pjesë në përgatitjen e strategjisë kombëtare në fushën e sigurisë elektronike, në përputhje me parashikimet sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik, për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara si dhe për sigurinë kibernetike.

4.11 Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të sigurisë elektronike.

4.12 Garanton kushtet për konkurrencën e lirë, ndërmjet ofruesve të kualifikuar të shërbimeve të besuara, të cilat mbështeten në parimet e transparencës, neutralitetit të teknologjisë, ekonomisë së lirë të tregut, mosdiskriminimit dhe ndershmërisë.

4.13 Zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe organizmave të testimit dhe konfirmimit.

4.14 Mbron të drejtat e përdoruesve të shërbimeve të besuara dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të kualifikuar të shërbimit të besuar dhe zotërueseve të certifikatave të kualifikuara.

4.15 Bashkërendon punën me institucionet publike dhe private, të cilat disponojnë sisteme kritike e të rëndësishme të informacionit, dhe përgjigjet me kundërmasa ndaj kërcënimeve/ sulmeve kibernetike.

4.16 Konsulton, propozon dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e programeve dhe ndjekjen e procedurave të veçanta, me qëllim përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve kompjuterike shtetërore ndaj veprimtarive të paautorizuara dhe/ose përpjekjeve për të zhvilluar një veprimtari të paautorizuar.

4.17 Verifikon sigurinë dhe përputhshmërinë e aplikacioneve të zhvilluara apo të implementuara nga autoritetet shtetërore.

4.18 Përcakton standardet minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve kompjuterike të shoqërisë së informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

4.19 Kontrollon implementim e të gjitha standardeve teknike të zbatuara nga institucionet e shoqërisë së informacionit.

4.20 Propozon plotësimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e veprimtarisë që mbulon.

4.21 Ngre, administron dhe mirëmban sistemin unik *on-line*, për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme, si më poshtë:

a) Faqet me përmbajtje të paligjshme konsta-tohen nga autoritetet publike dhe dërgohen zyrtarisht pranë Autoritetit, i cili u mundëson atyre të drejtat e aksesit në sistem, për publikimin e tyre, me qëllim mbylljen e këtyre faqeve.

b) Autoriteti nxjerr udhëzime për funksionimin e sistemit, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike, si dhe ofruesve të shërbimit të internetit (ISP-ve).

4.22 Publikon listën e rregullave minimale të sigurisë për të gjitha institucionet publike e private dhe realizon kontrollin periodik të zbatimit të tyre.

4.23 Krijon dhe përditëson regjistrin elektronik për procedurat e kontrollit.

4.24 Krijon dhe përditëson regjistrin elektronik të ngjarjeve/incidenteve kibernetike dhe regjistrin e pikave të kontaktit kombëtare/ndërkombëtare.

5. Autoriteti ka stemën dhe vulën zyrtare, sipas specifikimeve më poshtë:

5.1 Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

5.2 Vula e Autoritetit ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare.

5.3 Vula e Autoritetit përmban shënimin identifikues “Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

5.4 Vula e Autoritetit administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Autoriteti drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe mbikëqyr veprim-tarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët.

7. Drejtori i Përgjithshëm kryen këto detyra:

7.1 Përgatit analiza, raporte dhe bën propozime për mbarëvajtjen e punës së strukturave në varësi të tij.

7.2 Drejton, përpunon programin vjetor për angazhimet e drejtorive dhe përcakton prioritetet në punën e tyre.

7.3 Raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e institucionit pranë ministrit përgjegjës.

7.4 I propozon ministrit përgjegjës të fushës ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi.

7.5 Merr masa për administrimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e të burimeve materiale të institucionit.

8. Struktura e brendshme e Autoritetit miratohet nga Kryeministri sipas legjislacionit në fuqi.

9. Në të gjitha aktet nënligjore fjalët “Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik” dhe “Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike” zëvendësohen me “Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

10. Të gjitha të drejtat, detyrimet, kontratat dhe projektet që janë në proces dhe që i takojnë përkatësisht “Autoritetit Kombëtar të Certifikimit Elektronik” dhe “Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike” i transferohen “Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

11. Punonjësit aktualë të AKCE-së dhe ALCIRT-it, kalojnë tek Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit të nëpunësit civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

12. Fondet e miratuara për Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike në buxhetin e vitit 2017, transferohen në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në të njëjtët zëra buxhetorë.

13. Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, do të vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në momentin e fillimit të funksionimit të plotë të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike .

14. Vendimi nr.766, datë 14.9.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)”, shfuqi-zohet.

15. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**